



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 659 Prot.

Tiranë, më 29.04.2024

**V E N D I M**

**Nr. 119, Datë 29.04.2024**

Bazuar në nenin 32/1/c, nenin 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nenin 41/2/a<sup>1</sup>, të Kodit të Procedurave Administrative Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me urdhrin nr.95, datë 29.06.2021, ka filluar procedurat hetimore për ndjekjen kryesisht të çështjes në lidhje me mungesën e aktit nënligjor, për mënyrën e ekuivalentimit të notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja, me sistemin shqiptar të vlerësimit.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes kryesisht, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim.**

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave për shqyrtimin e ankesave nga ana e personave të cilët pretendojnë se janë diskriminuar, Komisioneri është vënë në dijeni të faktit se mungon rregullimi me një akt nënligjor, për sa i përket mënyrës së ekuivalentimit/konvertimit të notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja me sistemin shqiptar të vlerësimit<sup>2</sup>.

Bazuar në nenin 92, të ligjit nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se, diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes. Pra, procesi i njohjes dhe njësimit të diplomave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, paraqet një rëndësi në lidhje me të drejtën për të vazhduar arsimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri.

<sup>1</sup> “Fillimi i procedurës kryesisht është në diskrecionin e organit publik. Organi publik është i detyruar të fillojë procedurën administrative kryesisht kur: a) ligji ose akti nënligjor parashikon fillimin e procedurës”.

<sup>2</sup> Vendim nr.116, datë 29.06.2021, i Komisionerit.

Rezulton se praktika të ndryshme për të patur akses në punësim, arsim apo ndjekja e karrierës akademike, kushtëzohen nga kritere që lidhen me notën mesatare të studimeve të larta. Këtu mund të përmendim, praktikat e punësimit të studentëve ekselentë në administratë, mundësitë që ofrohen për studentët ekselentë në kuadër të Programit të Fondit të Ekselencës, kriteret në lidhje me notën mesatare që vendoset për Shkollën e Magjistraturës apo vazhdimin e karrierës akademike me qëllim për fitimin e titujve dhe gradave shkencore. Këto janë disa nga situatat të cilat Komisioneri ka konstatuar se, nota mesatare e studimeve të larta vendoset si kriter për të patur akses në punësim, arsimim apo karrierën akademike. Këto situata padyshim që nuk janë shteruese dhe kriteri i notës mesatare të studimeve të larta mund të vendoset si kriter edhe në situata të tjera të ngjashme.

Legjislacioni dhe aktet nënligjore në fuqi përcaktojnë qartë procedurat, mënyrën dhe autoritetet përgjegjëse, në lidhje me vlerësimin e arritjeve, notave apo notës mesatare, për studentët që ndjekin arsimin e lartë në një nga institucionet e arsimit të lartë në vend, në rastin e studentëve që zotërojnë një diplomë të fituar jashtë vëndit, nuk ka procedura të përcaktuara në lidhje me mënyrën se si konvertohen apo ekuivalentohen notat e fituara në një institucion të arsimit të lartë të huaj. Kategoria e studentëve që kanë fituar një diplomë universitare jashtë shtetit, përballen me pasigurinë në lidhje me mënyrën, procedurat dhe institucionin përgjegjës, gjithmonë në varësi të situatës.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e çështjesex- officio nga Komisioneri.**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup> është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar<sup>4</sup>, si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

<sup>4</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

1. Nëpërmjet shkresës me shkresën nr.993/1 prot., datë 07.07.2021 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për dijeni Këshillit të Ministrave, ka njoftuar Ministrinë në lidhje me fillimin e trajtimit të kësaj çështje kryesisht dhe marrjen e një informacioni të plotë dhe shterues, si mëposhtë:

- Cilat janë arsyet që, procesi i njohjes dhe njehsimit të diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, nuk rregullon edhe mënyrën e kriteret e konvertimit/ekuivalentimit të notave, që këta studentë kanë fituar në institucionet e huaja të arsimit të lartë, në sistemin shqiptar të vlerësimit?
- Si vepohet në rastin e personave të cilët kanë përfunduar studimet e larta jashtë vendit, kur për të patur akses në arsim, punësim apo për të ndjekur karrierën akademike, vendosen kritere në lidhje me notën mesatare të studimeve të larta? Cilat janë mënyrat, procedurat dhe autoriteti përgjegjës, për ekuivalentimin/konvertimin e notave, në mungesë të një akti nënligjor që rregullon këtë situatë?
- Çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm se do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

2. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresën nr.3869/1 prot., datë 16.07.2021, të administruar në KMD me nr. 993/2 prot., datë 21.07.2021, ka informuar Komisionerin, duke sqaruar se:

Me ligjin nr. 8834, datë 22.11.2001 "*Për ratifikimin e "Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë"* (Lisbonë, 1997)", Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Lisbonës, e cila ndër të tjera parashikon se njohje konsiderohet vërtetimi i lëshuar nga një autoritet kompetent për vlerën e një kualifikimi arsimor të huaj, me qëllim pranimin në aktivitet e arsimit dhe/ose të punësimit. Gjithashtu është e parashikuar se çfarë nënkuptohet me kualifikim të arsimit të lartë, i cili përfshin çdo gradë, diplomë, deftesë tjetër ose titull tjetër i lejuar nga një autoritet kompetent dhe që vërteton përfundimin me sukses të një programi të arsimit të lartë.

Në nenin III. 1 të Konventës, është parashikuar: "*1. Titullarët e kualifikimeve të dhëna nga njëra nga Palët kanë një hyrje të përshtatshme në vlerësimin e këtyre kualifikimeve, me anë të një kërkese të tyre adresuar një organizmi kompetent. 2. Në këtë pikë nuk bëhet asnjë dallim i bazuar në seksin, racën, ngjyrën e lekurës, handikabin, gjuhën, opinione politike ose çdo opinion tjetër, origjinën kombëtare, etnike ose sociale, përkatësinë në një minoritet kombëtar, pasurinë, lindjen ose çdo rrethanë tjetër të kërkuesve, ose çdo rrethanë tjetër që nuk ka lidhje me vlerën e kualifikimit për të cilën është kërkuar njohja. Për të siguruar këtë të drejtë, çdo Palë angazhohet të ndermarrë dispozitat e nevojshme për të vlerësuar çdo kërkesë njohje të kualifikimit, duke marrë parasysh vetëm njohtet dhe aftësitë e fituara. Ky parashikim përveç se shpreh detyrimin për të zbatuar mosdiskriminimin shpreh se njohja realizohet duke pasur në konsideratë afësitë e fituara dhe rezultatet e kualifikimit, përcaktim që vijon të zbatohet pasi*

në dokumentin e njohjes në zbatim edhe të legjislacionit të sipërcituar përcaktohet niveli i kualifikimit sipas ciklit të programit të studimit (p.sh Bachelor, Master etj.) dhe program i studimit i ndjekur ( p.sh në drejtësi, shkenca politike etj.)

Në vijim të miratimit të Konventës u miratua ligji nr. 9741, date 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (i shfuqizuar), i cili ka pasur të parashikuar në dispozitat e tij përcaktimet e Konventës mbi njohjen e diplomave të huaja, ku në pikën 1 të nenit 37 parashikohet se: "*1. Nëpërmjet procedurës së njohjes, një diplomë e huaj njehësohet me një diplomë shqiptare nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin dhe e së drejtës për punësim. Kjo vlen dhe për njohjen e çertifikatave, gradave ose titujve të huaj*", dhe në nenin 38 të tij, parashikohet si vijon: "*1. Nëpërmjet ekuivalentimit, pjesë ose programe të plota studimi ose diploma të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja njihen dhe ekuivalentohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimitë njëjtë ose e ngjashme. 2. Ekuivalentimi bëhet nga institucioni i arsimit të lartë, pranë të cilit është paraqitur kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm.*"

Aktualisht sipas legjislacionit në fuqi, në nenin 92 të ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", parashikohet njohja e diplomave, çertifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të cilat njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes. Pika 6, e këtij neni ka autorizuar ministrin përgjegjës për arsimin për të përcaktuar me udhëzim procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, çertifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademike të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen. Siç shihet parashikimi ligjor ka autorizuar njohjen e dokumentit zyrtar të përcaktuar konkretisht, diplomë apo çertifikatë, për pasojë edhe praktika e ndjekur ka qenë ajo e njohjes dhe njësimit sipas këtij përcaktimi. Në referim të këtij autorizimi ligjor dhe në zbatim edhe të pikës 1 të nenit 118 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 80/2015 sipas të cilit aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë është në fuqi udhëzimi nr. 17 datë 03.08.2016, i ministrit të Arsimit dhe Sportit "*Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, çertifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademike të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit*". i ndryshuar.

Po ashtu në nenin 89, të këtij ligji është parashikuar se periudhat e studimit dhe detvrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja kryhet nga institucioni i arsimit të lartë, pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve. Aktualisht një pjesë e institucioneve të arsimit të lartë e kanë të rregulluar në statutin e institucionit apo te akte të tjera rregullatore të

brendshme konvertimin e notave apo krediteve të fituara jashtë vendit, në referim të këtij parashikimi dhe në zbatim të autonomisë së tyre të parashikuar në pikën 7, të nenit 57 të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 80/2015.

Për sa me lart, MAS konsideron se procesi i njohjes dhe njësimit realizohet nga strukturat kompetente të caktuara sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me aktet rregullatore ligjore dhe nënligjore dhe Marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë, ndërsa ekuivalentimi i notave për diplomat dhe certifikatat e fituara jashtë vendit i takon institucioneve apo subjekteve që i vendosin ato si kriter arsimimi, punësimi apo karriere akademike.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 2, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.”*

Në nenin 3/1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombetare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit gëzon një mbrojtje të veçantë sipas ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në nenin 17/1ç, 17/2 dhe 17/4, të këtij ligji, përcaktohet: *“1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre. 2. Ndalohet t'i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...4. Zbatimi i masave të posaçme*



*dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshtetshmëri dhe barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta...”.*

Njohja e diplomave, certifikatave e gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit dhe njohja e titujve të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, aktualisht përcaktohet nga legjislacioni në fuqi që është ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”. Konkretisht në nenin 92, të ligjit të sipërcituar sanksionohet se:

*“1. Diplomat, certifikatat e gradat e fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, që i përkasin niveleve nga 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, njihen dhe njësohen përmes lëshimit të dokumentit zyrtar, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, në përfundim të procedurës zyrtare të njohjes.*

*2. Një kualifikim apo program studimi i kryer jashtë vendit, për të cilin është lëshuar një certifikatë, diplomë apo gradë nga institucioni i huaj, i autorizuar në vendin përkatës për lëshimin e tyre, që vërteton përfundimin e kualifikimit apo programit të studimit, vlerësohet, njihet dhe njësohet në bazë të Kornizës Europiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës së Kualifikimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë.*

*3. Institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin zyrtar, në Republikën e Shqipërisë, të certifikatave, diplomave dhe gradave shkencore është ministria përgjegjëse për arsimin. Ky proces kryhet nga njësi përgjegjëse e njësimit të diplomave.*

*4. Titujt e lëshuar jashtë vendit nga një institucion i huaj i arsimit të lartë njihen në Republikën e Shqipërisë, të barasvlershëm nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar punësimin ose karrierën akademike në Shqipëri, përmes procedurës zyrtare të njohjes.*

*5. Institucioni përgjegjës për njohjen zyrtare, në Republikën e Shqipërisë, të titujve akademikë të lëshuar jashtë vendit është ministria përgjegjëse për arsimin.*

*6. Procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, si dhe njohjen e titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga vendi ynë për këtë qëllim. Ministria përgjegjëse për arsimin mund të përcaktojë dhe vlefshmërinë e diplomës së njësuar, sipas fushës së punësimit.*

*7. Ministria përgjegjëse për arsimin mban bazën e të dhënave kombëtare të diplomave, certifikatave, gradave dhe titujve të njësuar apo të njohur në Republikën e Shqipërisë.”.*

Në zbatim të autorizimit të mësipërm ligjor, rezulton se MAS ka miratuar udhëzimin nr.17, datë 03.08.2016 i Ministrit të Arsimit “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucionet e arsimit të huaj të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit” dhe praktika e ndjekur nga qenë ajo e njohjes dhe njësimit sipas këtyre përcaktimeve.

Neni 89 “Transferimi i studimeve Njohja dhe njësimi i periudhave të studimit”, të ligjit nr. 80/2015, përcakton se:

- “ 1. Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë.
2. Periudhat e studimit dhe detyrimet e programeve të studimit, të shlyera në institucione të tjera të vendit ose të huaja, njihen dhe njësohen, nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm.
3. Njohja kryhet nga institucioni i arsimit të lartë, pranë të cilit është paraqitur kërkesa për vazhdimin e studimeve.
4. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
5. Kriteret e procedurat e njohjes së krediteve dhe transferimi i studimeve përcaktohen në rregulloren e njësisë bazë, në përputhje me këtë ligj dhe akte të tjera nënligjore. 6. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet, më qëllim vazhdimin e studimeve në institucionin pritës të arsimit të lartë, i takon komisionit përkatës, të ngritur nga njësia bazë e institucionit të arsimit të lartë.”

Në zbatim të autonomisë që institucionet e arsimit të lartë kanë në bazë të nenit 57, pika 7, të Kushtetutës si dhe bazuar në këtë dispozitë ligjore, MAS parashtroi se, një pjesë e institucioneve të arsimit të lartë e kanë të rregulluar në statutin e institucionit apo akte të tjera rregullatore të brendshme konvertimin e notave apo krediteve të fituara jashtë vendit.

Sipas MAS, procesi i njohjes dhe njësimit realizohet nga strukturat kompetente të caktuara sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me aktet rregullatore ligjore dhe nënligjore dhe Marreveshjet ndërkombetare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë, ndërsa ekuivalentimi i notave për diplomat dhe certifikatat e fituara jashtë vendit i takon institucioneve apo subjekteve që i vendosin ato si kriter arsimimi, punësimi apo karriere akademike.

Nëpërmjet këtij qëndrimi MAS konfirmon në fakt konstatimin e bërë nga ana e Komisionerit se nuk ka një akt nënligjor që rregullon në mënyrë të unifikuar mënyrën e ekuivalentimit të notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja, me sistemin shqiptar të vlerësimit.

Udhëzimi nr.17, datë 03.08.2016 i Ministrit të Arsimit “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve

*akademikë të lëshuar nga institucionet e arsimit të huaj të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar përmban rregulla për mënyrën e aplikimit, dokumentacionit që duhet të përmbajë aplikimi, procedurat e njohjes, afatet, tarifat dhe të drejtën e ankimit, por nuk ka asnjë përcaktim për mënyrën e ekuivalentimit të notave të që studenti ka fituar në institucionet e huaja të arsimit të lartë, me sistemin shqiptar të vlerësimit.*

Rezulton se udhëzimi nr.17, datë 03.08.2016, i Ministrit të Arsimit, është shfuqizuar dhe aktualisht procesi i njohjes dhe njësimit të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, kryhet bazuar në Udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar*”<sup>5</sup>.

Në momentin e miratimit të udhëzimit nr.21, datë 15.10.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit si dhe në vijim të ndryshimeve që ka pësuar ky akt nëpërmjet udhëzimit nr.18, datë 08.07.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, konstatohet se, nuk ka përfshirë parashikime për të rregulluar mënyrën e ekuivalentimit të notave.

Rezulton se, me udhëzimin nr.1, datë 19.01.2024, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “*Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në republikën e shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, të ndryshuar, ky udhëzim ka pësuar disa ndryshime. Një nga ndryshimet dhe shtesat është:*

*“b) Pas pikës 3.1, të kreut II, shtohet pika 3.2, me përmbajtje si vijon:*

*“3.2 Pas njohjes dhe njësimit të diplomës, QSHA-ja bën llogaritjen e mesatares së vlerësimeve të arritura brenda 5 (pesë) ditëve pune. Njëvlershmëria e mesatares së vlerësimeve të arritura në shtetin përkatës kryhet për çdo vlerësim/notë që aplikanti ka fituar sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në tabelë, në shtojcën nr. 6, të këtij udhëzimi, njëvlershmëria bëhet në bazë të informacioneve të marra në faqen zyrtare të rrjetit ENIC-NARIC, ose agjenci dhe/ose ente akredituese të IAL-ve të huaja.”*

Nga shqyrtimi i shtojcës nr.6, që i bashkëlidhet udhëzimit, paraqitet tabela e njëvlefishmërisë së notave të fituara në shtetet Australi, Francë, Gjermani, Hollandë, Irlandë, Itali, Kanada, Mbretëria e Bashkuar, Portugali, SHBA, Spanjë, Turqi, Zvicër, Greqi, Maqedonia e Veriut, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Kinë, Rusi, me ekuivalenten e këtyre notave me sistemin shqiptar të vlerësimit.

<sup>5</sup> Ndryshuar me udhëzimin nr. 18, datë 8.7.2022 dhe udhëzimin nr. 1, datë 19.1.2024.



Në nenin 90, “Përfundimi i procedurës administrative”, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, sanksionohet se: “3. Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrative.”. Ndërsa, në nenin 95 “Pamundësia në objekt apo qëllim”, të Kodit të procedurave Administrative, parashikohet si vijon: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi dhe objekti për të cilin ka filluar kryesisht procedura administrative për shqyrtimin e çështjes mbi mungesën e aktit nënligjor, për mënyrën e ekuivalentimit të notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja, me sistemin shqiptar të vlerësimit, është përmbushur dhe rrjedhimisht në mbështetje të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilën parashikohet se, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur procedura është bërë i pamundur, në rastin konkret pasi është përmbushur dhe realizuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi se procedura duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “c”, nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenin 90, pika 3 dhe nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Të deklarojë të përfunduar pa një vendim përfundimtar, procedurën administrative për shqyrtimin e çështjes së filluar kryesisht, mbi mungesën e aktit nënligjor, për mënyrën e ekuivalentimit të notave të arsimit të lartë të institucioneve të huaja, me sistemin shqiptar të vlerësimit.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

Fusha:           Arsim

Lloji i vendimit: Ndërprerje/pamundësi në objekt dhe qëllim